



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 pika k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 5 janar 2024, Ligjit nr.2004/32 për Familjen e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.4 e datës 01 shtator 2006, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për familjen nr.2004/32 për familjen e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 3 e datës 17 janar 2019, Ligjit për Mbrojtjen e fëmijës Nr.06/L-084, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 14 e datës 17 korrik 2019 si dhe neneve 9 pika k) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.04.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

#### VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KOMUNAL PËR STREHIM FAMILJAR PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2025-2027

##### Neni 1

MIRATOHET „Plani i veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027.

##### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027.

##### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- Qendra për Punë Sociale në Lipjan .

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

15 Nr. 360/09-20984

Lipjan, më 24.04. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

